



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 41

Datë: 17. 08. 2017, ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyesë: Vera Dula

Rendi i ditës

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 - *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.34-40/2017:*
2. Aktivitetet e ZRPP-së:
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për certifikim të iniciativës qytetare “Iniciativa e Therandës”;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për certifikim të kandidatit të pavarur;
3. Raport i Këshillave të KQZ-së:
 - Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i vizitës studimore në Londër;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në Konferencën e ACEEEO-së në Bullgari;

- Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes në Konferencën e ODIR-it në Poloni;
- Këshilli për Operacione Zgjedhore:
- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më datën 11 qershor 2017;

4. Të ndryshme.

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së:

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KOZ-së nr.34-40/2017:*

Valdete Daka: Vazhdojmë me mbledhjen e 41 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, Fehmiu tash më kallxoi që nuk ka arrit mi përgatit procesverbalet, kështu që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendit të ditës. Nën 2, “Aktivitetet e ZRPP-së”, drejtoresha po ashtu, propozon që të hiqen këto pikat e rendit të ditës dhe të zëvendësohet me pikat e rendit të ditës, që është: “Rekomandim për miratimin e ndryshimit të emrit të partis politike “Gracansa Iniciativa Srbska Lista”, në “Srbska Lista”. D të thotë, rekomandim për miratimin e ndryshimit të emrit të partis politike “Gracansa Iniciativa Srbska Lista” në “Srbska Lista”. D.m.th të hiqet kjo pika e dytë dhe të zëvendsohet me atë që e lexova, edhe këto pikat tjera mbesin të gjitha qoftes pajtoheni.

Valdete Daka: Vazhdojmë tutje, kjo pikë e rendit të ditës të hiqet, pika e dytë hiqet në vend të saj futet rekomandimi i zyrës.

Adnan Rrustemi: Unë jam kundër këtij rekomandimi për t’u futur në rend të ditës. Personalisht mendoj, ndoshta jam gabim por është hera e parë që na parashtrohet rekomandim për miratim të emrit. Pse na duhet me miratuar rekomandim për ndryshim të emrit, nëse e ka bo me përputhje me statusin t’i mundesh me na njoftu, por jo me miratuar tash çdo detaj të ndryshimit brenda një subjekti politik. Nuk na takon, gjema referencën në ligj dhe në rregull, nuk mundemi ta miratojmë emrin, a pe kupton KQZ-ja... Nuk e kemi obligim, kompetencë nuk e kemi, ata nëse e kanë bërë në përputhje me statutin, edhe zyra sigurohet që e ka bërë në përputhje me statutin, e shumta, neve mundet vetëm me na njoftuar, kaq përfundon... Unë, nuk votoj asgjë në këtë aspekt...

Bajram Ljatifi: Ne, nuk vendosim, nuk marrim vendi, Zyra vetëm na njofton...

Valdete Daka: Pra, ky është vetëm njoftim për ndryshimin e emrit...

Betim Gjoshi: Unë prej se jam antar i KQZ-së, i kemi pasur 3-4 raste ndryshime të emrit. E di që AAK-ja e ka ndërruar emrin prej partive të shumicës, edhe partive të pakicave kanë ndërruar emrat, p.sh “Social Demokracia”. Edhe unë mendoj që në KQZ nuk e kemi qit, çka mendoj që në këtë rast zyra duhet me përfunduar njoftimin, a ka qenë në bazë statusi në rregull por edhe a është ky emër fyes edhe në përputhje me kushtetutën, këtë garancion me na dhënë dhe me vazhdu më tutje. Nëse kjo, drejtoresha mendon që nuk është në përputhje atëherë ne kishim mundur me marr ndonjë, por në këtë rast po pajtohemi me koleg le të mbetet njoftim për ndryshimin e emrit...

Valdete Daka: Pika është njoftim për ndryshimin e emrit... Mirë, atëherë kush është për këtë pjesë.

Bajram Ljatifi: Në të ndryshme, dua të theksoj çështjen e shqiptimit të dënimeve subjekteve politike nga zgjedhjet e kaluara... Shërbimi, nuk ka kryer punën si duhet: nuk i ka ndalë gjrobat...a, regjistrimi është deri më 22...

Valdete Daka: Ne e diskutojmë sa të doni. Vendim nuk mundemi me marrë, nuk kemi çfarë të marrim. Atëherë kush është për këtë rend dite. Kush është për këtë rend dite?

Anëtarët e KQZ, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Faleminderit. Vazhdojmë me pikën e par, ajo është në fakt ndryshimi nga zyra, Urdhëro drejtoresh.

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

Miradie Mavriqi: Faleminderit kryetare. Partia politike e regjistruar me emrin “*Gracansa Iniciativa Srbska Lista*” me akronimin “GSL” ka mbajtur kuvendin e saj zgjedhor komform legjislationit do të thotë brenda 6 muajve nga regjistri i saj në Komisionin Qendror Zgjedhor. Kjo parti ka dërzuar edhe në afat ligjor të gjitha ndryshimet që i ka bërë, ka dërzuar listën e delegatëve, procesverbalin, statutin, pikat në statut që i ka ndërruar, simbolin dhe formularin për ndryshime ku do të thotë janë paraqitur ose është dërzuar kryesia e re, prej 9 anëtarve. Kuvendi nga “*Gracansa Iniciativa Srbska List*” në “*Srbska Lista*” do të thotë është larguar ajo Iniciativa që ka qenë më parë. Dhe është zgjedh edhe kryetari i ri i partis politike. Në kuvend kanë marrë pjesë 23 delegat, sepse janë ka monitoruar kuvendin zgjedhor kryetari jon komunal i komunës së Mitrovicës. Zyra ka konstatuar se janë respektuar procedurat e rregullës numër 1/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike, gjegjësisht neni 10, 14 dhe 15 dhe njofton KQZ-në tani se është rekomandim që këto ndryshime janë komform legjislationit ose rregullës në fuqi. Faleminderit.

Binak Vishi: Pasi ka propozim me ndryshuar emrin, besoj se e ndryshojnë edhe stemën. Ta shohim si duket...!

Eshref Vishi: Ka qenë një pakënaqësi e tyre e kanë kundërshtuar njëra tjetrës.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoresh. Nëse nuk kemi diçka tjetër lidhur me këtë pikë vazhdojmë me pikën e tret.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- *Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë;*

Shqyrtimi dhe miratimi i vizitave në Angli, Poloni dhe Bullgari

Valdete Daka: Siç e dini ne para dy dite kemi pasur një mbledhje të këshillit me marrëdhënie me jashtë. Nuk na kanë shkepur, Valmir i thua Megit le ti bjen këto për ACEU edhe këtë për ODIR, për Londër ja ku e kam se nuk kam çfarë me shpërnda, se ne një here kemi shpërnda më herët atë letër. Por letrën e ambasadës së ambasadorit të OSBE-së e keni të gjithën në email, letrën që na u ka përgjegj refuzimin. Nuk e ke parë por e ke në e-mail të gjithë para disa dite. D.m.th ambasadori siç e dini ne kemi kërkuar ndihmë financiare dhe teknike nga OSBE-ja, para disa ditëve ambasadori na është drejtuar na ka kërkuar falje që nuk mundet me qenë se në këtë vit nuk e kanë paraparë projekte të tilla. Mirëpo ka kërkuar mirëkuptim prej neve dhe ka premtuar dhe do ta shqyrtojnë mundësin që vitin e ardhshëm kjo të futet në program të OSBE-së, dhe të shqyrtohet si projekt dhe si mundësi për mbështetjen e KQZ-ës. Ndërkohë ky Fitimi, që këtë letër e kam që u`a bijnë ma ka dërguar një e-mail dhe ka kërkuar. Po u`a lexoj më shkurt mos ta zgjasim se është e shkurt, po ju shkruaj në lidhje me vizitën studimore të planifikuar në Britani të Madhe dhe siç ju kam informuar takimet tuaja janë konfirmuar për datat 18 dhe 19 shtator, është momenti i fundit për të aplikuar për viza në mënyrë që të arrihet kohë për vizitë studimore. Prandaj dëshja të di si shkon situata rreth financimit të vizitës dhe nëse nuk arrihen të sigurohen mjete për tërë delegacionin do të ishte e rrugës duke marrë parasysh punën e bërë deri tani për organizim të vizitës që së paku një grup më i vogël i kryesuar nga ju të realizoj këtë vizitë studimore, me respekt Fitim Mulolli. D.m.th kjo është ajo që Fitimi ka kërkuar prej neve, ne tash duhet me vendos a do të realizohet kjo vizitë apo jo, dhe nëse realizohet ka kërkuar që formati të zvogëlohet për shkak të pa mundësis së sigurimit të mjeteve financiare për gjithë KQZ-në. Ne si këshill për marrëdhënie me jashtë kemi shqyrtuar këtë dhe kemi ardhur në përfundim, megjithatë KQZ-ja të vendos edhe pse ne kemi ardhur në përfundim me anulë të gjithën ndoshta edhe nuk dalim shumë serioz për shkak se tashmë qysh u`a lexova janë konfirmuar takimet të gjitha, është bërë i gjithë anarzhimi për këtë vizitë nga ana e KQZ-së në Britani të Madhe dhe atyre që kemi pasur të takoheni me ta dhe ta shqyrtojmë mundësin që së paku bile një grup prej 4 eventualisht 5 antarë të KQZ-së dhe 1 nga përfaqësues nga zyra ta realizoj këtë vizitë me atë që vitin e ardhshëm të shqyrtohet mundësia që të realizohet edhe një vizitë tjetër së bashku me këtë fondacion dhe me përkrahjen e OSBE-së. Kjo është pra e gjitha

edhe ne duhet pa tjetër sot me vendos ose me anuluar ose me vazhduar me procedura, për shkak të vizave sepse e dini që vizat për Angli janë shumë të komplikuar dhe kërkon kohë për marrjen e tyre vizave. Situata është kështu, tash duhemi me vendos. Po urdhëro Betim.

Betim Gjoshi: Realisht, ju e dini se privatisht me shumicën kam biseduar. Kam qenë për me anuluar, sepse ka qenë një qëndim i përbashket më shkuar të gjithë se bashku. Shkresa që iu referove, realisht nuk thotë mos e jani të gjithë. Ky është qëndrimi i tyre. Por për mua është e paarsyeshme me shkuar të gjithë. Mes të dyave, unë e përkrahi rekomandimin e këshillit që me shku 4 ose 5 prej KQZ-së ne krye me ju. Nuk e di për punën e zyrës. Zyra tregon vet, a është e interesuar me shkuar në këtë fazë apo jo. Siç e dimë, është rikonfiguruar programi për parti politike dhe financa. Është një takim 2 orësh. Pjesa tjetër ndërlidhet për aktivitet të gjithëmbarshëm të KQZ-së. Kjo e vlerëson vet. E ka agjendën para vetës dhe e sheh. Unë personalisht hjeju dorë për me qenë pjesë e delegacionit me qëllim që, ndoshta, më lehtë arrini te një kompletim i delegacionit në mënyrë vullnetare, pa iu mbetë hatri. Është vizitë e rëndësishme. Me u takuar me përfaqësuesit e dy partive kryesore të Anglisë, me KQZ të atij vendi e me shumë të tjerë nuk është pa rëndësi. E kish pasë dëshirë secili prej neve dhe drejtuesve, por po du me dhanë shembull. Dhe kisha menduar që delegacioni me qenë i udhëhequr prej kryetares me marr pjesë 2 ose 3 antarë të Kosmisionit Qendror Zgjedhor prej pjesës shumicës një nga komunitetet dhe kështu a i din për me lehtsu nashta si formul edhe unë nashta me emra ka pas të drejtën me votu po sbesoj që i takon ish kanë mirë këshilli më na i pru emrat ma lehtë e kanë pas po si do që të jetë na mujna me mrrri edhe këtë mënyrën zbritje se kush po hjekët e kush po shkon edhe mbërin deri te ai.

Valdete Daka: Faleminderit Betim, na me gjithat e kemi diskutu në një farë forme kemi thanë që na e kemi pas edhe një vizitë në Londër edhe qe një pjesë prej neve kanë qenë pjesëmarrës të asaj vizite atëhere dhe që ka tash antarë të dy palëve tash nuk po di qysh me ju thanë pozitë opozitë as edhe nuk kisha thanë se nuk e kemi diskutu në atë drejtim po vetëm nga ajo që gjithsesi prej minoriteteve duhet me qenë dikush edhe na pjesa tjetër qysh do që të mirremi vesh pa hatër mbetje kish me qenë mirë që në qofse mundeni me arritë një far lloj marrëveshje kish me qenë , na të gjithë e dimë se kush qka ka qenë?

Ercan Spat: Po faleminderit, edhe unë ju kujtohet në këshill që përkraha iden që të shkohet edhe këtu dhe e përsëris të njëjtën, kështu me një grup ma të vogël..., vetë personalisht nuk jam i intersum me shku të ia lehtësoj kolegëve.

Valdete Daka: Faleminderit, tash veq i kem dy që janë deklaruar që nuk janë të interesum, kishë me qenë mirë që prej minoriteteve me na tregu kush është i interesum , kujt i bjen diqysh qysh me thanë radha që me pas ma të lehtë mandej me vazhdu me pjesën tjetër me qense tash më Ercan dhe Betimi u tërhoqën, po Bajram ?

Bajram Ljatifi: Edhe unë, tash nuk mundem të udhëtojë...

Valdete Daka: Faleminderit Bajram, edhe Bajrami u deklarua pra. Po tash me qenë se po flasim Nenadi ka qenë pjesë e disa vizitave edhe në Shtetet e Bashkuara, një vizitë që e kemi bo edhe disa vizita tjera kështu që po më duket pjesmarrësi nga komuniteti e kemi Ergiti, pjesa tjetër qysh do që merreni vesh.

Betim Gjoshi: Pjesa tjetër, tash ti kryetare dy tash ju mbetet prej këtyre pesë, tre me shkuar kryhet muhabeti, tash edhe një hiq edhe dy ndash le të merren vesh.

Valdete Daka: Nuk mundem me përpilu lista, sepse nuk kam përpliluar kurr. ACEEO, është në nëntor, por tash për t'ju njoftuar e kemi vizitën e ACEO-së në të vërtet konferecën e ACEO-së në Sofie e cila do të mbahet në nëntor e kemi por nuk e di në cilën datë, në nëntor e di që është. AVEBI-n, e kemi në Rumani, e kemi të përcaktuar grupin, por dihen edhe në AVEB janë Betimi, Adnani edhe unë prej KQZ-së, Samiu nuk është në list kërkund.

Betim Gjoshi: Përnjëmend është mjaft lehtë, Adnani besoj që është i mirëkuptueshëm se herën e fundit Samia, Iliri po mbetet mes Eshrefit edhe Binakut njëfar mënyre, ose Binaku besoj që ish kanë mjaftueshëm që kishin mundur me na përfaqësuar se di, munden mu kombinuar diku tjetër këta tjerët. Edhe për ta marr fjalën në AVEB, në ACEEO unë nuk shkoj...

Binak Vishi: Tash nëse ashtu, jemi në një situat të keqe se qefi është më i madh. Nëse shkon njëri andej, bile tjetri me kanë dika tjetër, se Adnani ju ketë në Bukuresh apo ku ketë Budapest le të jetë edhe Eshrefi. Unë për qejf në Londër shkoj nuk e fshehë, nëse është e mundur po që jo nuk jam me prish.

Betim Gjoshi: Kryetare u kry kjo e Londrës, për ACEEO...!

Valdete Daka: D.m.th. Valdetja për Ergitin që po e dimë Samiun që po e dimë Iliri edhe Binaku, edhe i zyrës, d.m.th gjashtë po bëhen. Miradia d.m.th. kjo po i bie për Londër, hajde hajërli koftë. Shkojmë Sofia, Eshrefi i pari Adnani. Prej 8 deri më 10 qenka, sa veta këta nuk kanë thanë sepse këta nuk paguajnë asgjë, d.m.th na vendosim.

Betim Gjoshi: Nëse është me makin, nja pesë, gjashtë veta do ishte mirë me shku. A bën kryetare, unë po mendoj që në Sofie një është mirë të shkoj i sekretariatit pa diskutim sepse edhe konferencat janë të tilla edhe katër ose pesë të KQZ-së, tash nuk e di a je e interesuar me shkuar ti apo jo, unë për veti nuk jam i interesuar me shkuar realisht jam se në konferencat e ACEEO kam qenë më së paku ka qe 7-8 vite qe nuk jam kam qenë por nuk jam.

Valdete Daka: Atëherë kështu, Eshrefi, Kryeshefi, Adnani, unë më shumë se katër vet nuk i kisha bo me thënë të drejtën pesë, dy kerre munden më shku.

Betim Gjoshi: Dy prej komuniteteve, Bajrami...

Valdete Daka: E unë, a me shku a jo në Sofie, nuk kamë qenë në Sofie kurrë asnjëhere nuk po më bien diçka me shku në Sofie. Demek kështu, Valdetja, Eshrefi, Adnani, Kryeshefi, Bajrami,

Betimi edhe, gjashtë u bëme deri tani, gjashtë jemi boll. Në ndërkohë se Sofia është larg mundemi me plotësu, kjo u krye. Tash për ODIR kjo është veç njoftim, me ju njoftuar se ODIRI at ditë na njoftoj ambasadori që, ODIRI është duke e organizuar një ngjarje e ajo është ndihma për zgjedhje për trupat menagjuese të zgjedhjeve për Ballkani Përendimor të gjithë nga regjioni janë të ftuar. Shteti jon është për herë të par i ftuar duke e marr parasysht qe OSBE-ja nuk na e ka njohur, jo i ftuar por ata në fakt ata e kanë organizuar ata e kanë mbuluar shpenzimet ata i kanë bërë krejt edhe më kanë ftuar mu si kryetare, Betimin si antarë edhe Besnik Buzhalan me sa e di si lista votuese, jo vetëm këta ata kanë dërguar disa emra, por ata vetëm këta emra i kanë thirr me ftesa. Ndërkaq kanë ftuar OJQ-të edhe përfaqsesit e medieve, drejtorin e RTK-së, Adnan Merovcin, çka është ajo Këshilli i pavarur për media, BZAP-in nuk e kanë thirrur a në Bullgari vijne të gjithë të dhjetit. Në fakt KQZ-ja këtu nuk ka kurfar implikimi përveç që na vyen një vendim formalisht me marr për shkak të atyre mjeteve 20%, se ata e mbulojnë tërë këtë pjesën tjetër.

Betim Gjoshi: A bënë kryetare, nëse më lejon faleminderit, mas pari përnime unë e kom ni vetën pak keq tek qikjo situata e OSB-se edhe nuk kom guxu as me fol me kërkon deri sa më ke kallzu që je i thirr edhe ti, nuk disha as kan e kan ftu as kan se kan ftu e vërtet është që në Tiranë ambasadorin na kena me ftu me 3, 4 antarë dhe disa tjerë, por nuk e kam ditur kënd. Adnanin dje e kam pyet a je i ftuar.

Adnan Rrustemi: Bujar Basha më ka thënë që e kemi dërguar emrin tënd, të Betimit, dhe tha pritë aplikacionin, por nuk jam i interesuar në këtë datë me shkuar.

Betim Gjoshi: çka n`a kanë hjekur ata është se dy ditë kane hjekur shpenzimet. Kemi me qëndruar 3 ditë e 2 netë. Një ditë nuk i pjekin shpenzimet. I pjekin biletën e avionit, fjetjen, mëditjen për ushqim. I paguajnë edhe shpenzimet e vizës, që është mirë me e njoftuar edhe Besnikun. Edhe taksën e vizes, dhe çdo gjë ke me ia dërguar atyre ata i paguajnë. Përveç kësaj, nëse paguajmë ne taksi deri në aeroport, ata i paguajnë. Nuk kemi asnjë shpenzim, përveç nëse marrim meditet 20% edhe atë ditë, por edhe mos me marrë nuk është problem.

Valdete Daka: KQZ nuk ka ndonjë barrë. Kjo është shumë me rëndësi, sepse dje ma dërguan një email, ku më thanë që prap jemi shumë të lumtur që keni me ardhur, sepse është hera e parë që Kosova merr pjesë në këso lloj. Ka përkthim. Ata e mbulojnë. Shteti ynë për herë të parë atje paraqitet si Kosovë, barabartë me shtete tjera të Ballkanit Perëndimor. Atje është mundësia edhe e takimeve edhe të bashkëpunimit me ODIR-in. Sepse, kjo, mos e harroni është ODIR-i, nuk e organizon OSBE e Prishtinës, por OSBE ODIR.

Betim Gjoshi: Ballkani Perëndimor po i referohen si term, janë Bosnja, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria dhe Kosova dhe Maqedonia. Këto 6 shtete. Përkthimi ish në këto 6 gjuhë. Shkruake që në konferencë folet anglisht dhe këto 6 gjuhë tjera. Gjuhe të delegacioneve. Çka ka qenë me rëndësi, sepse e njej gjuhën angleze me mirë, ndoshta me ia dërguar një shkresë, a kemi me bë prezantime për ndonjë temë?

Valdete Daka: Agjendën e kemi marrë, aty nuk ka.

Betim Gjoshi: Unë e pashë që aty nuk ka emra të asnjë referues. Dikush ka me i referuar ato tema. Është shumë me rëndësi, pasi jemi për herë të parë. Ata kanë me vazhduar projektin në Kosovë. Prej 1 janar 2018 ODIR vjen në Kosovë, për këta hapja është hapur në këtë mënyrë kaq.

Valdete Daka: E bëjnë lansimin e këtij projekti. Unë komunikoj me ta. Nëse ata kërkojnë, unë mundem me prezantuar. Me përgatitë së bashku të gjithë e përgatisim atë prezantim. Nëse kërkojnë nga ne. Për të gjithë këto na duhen vendime.

Betim Gjoshi: Kryetare, vendimin merrne konform sa ditë keni me qëndruar. 2 ditë, 1 ditë, duhet me paguar KQZ-ja. Sepse edhe pse i kryen, duhet me pasur me vete mjete, mos me mbetë keq. Dhe përfaqësone KQZ-në sa më devotshëm, sa më mirë.

Binak Vishaj: Zonja Daka pa ja nis ti tash po folim seriozisht kush ka për Londër o mirë nesër mas largti me fillu me apliku se 3 jave ditë me i pru dokumentat edhe me filluar...

Betim Gjoshi: Me rreziku mos rrezikoni se vendimi është serioz ne qofse e shihni që spo muni me mrri e kisha shti pagesën 280 euro e paguni pak ma shtrejt traifen e vizën e nxirrni për 5 ditë vizën po nesër sigurone me apliku, ju nderveqson se në menyre verbale ju qon , qysh na kanë qu edhe neve për Varshav kryetare na kish qu ministria Odirin në mënyre verbale në ambasadë...

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më datën 11 qershor 2017

Adnan Rrustemi: Është një kërkesë për zëvendësim të një antari të KKZ-së në Fushë Kosovë nga Lëvizja VV, d.m.th Shpend Bardiqi i cili zëvendësohet me Drilon Bekteshin ku i cili e rekomandon KQZ-në.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
